

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TROPOJË
KËSHILLI BASHKIAK

Komisioni Barazisë Gjinore dhe Gjithpërfshirjes Sociale
të Këshillit Bashkiak Tropojë

RAPORT VENDIMMARRJE

Nr. 01 datë 03.05.2025

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit për Planin e Barazisë Gjinore të Bashkisë Tropojë

Komisioni Barazisë Gjinore dhe Gjithpërfshirjes Sociale të Këshillit Bashkiak Tropojë, në mbledhjen e tij, shqyrtoi dhe analizoi Planin e Barazisë Gjinore të Bashkisë Tropojë për periudhën afatmesme. Pas vlerësimit të dokumentacionit dhe bazës ligjore, komisioni thekson se ky plan është një instrument strategjik për promovimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e rolit të gruas në jetën shoqërore, ekonomike dhe politike.

Baza Ligjore

- Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji nr. 9970, datë 24.07.2008, “Për barazinë gjinore në shoqëri” i ndryshuar;
- Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” i ndryshuar;
- Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030;
- Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW);
- Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG 5: Barazia Gjinore).

Rëndësia e Planit

Plani i Barazisë Gjinore është një dokument politikash që synon:

- Të promovojë barazinë dhe përfshirjen gjinore në të gjitha fushat e jetës publike dhe private;
- Të fuqizojë rolin e grave dhe vajzave në vendimmarrje lokale;
- Të garantojë akses të barabartë në shërbime sociale, arsim, shëndetësi dhe punësim;
- Të reduktojë diskriminimin dhe dhunën me bazë gjinore;
- Të nxisë zhvillim të qëndrueshëm përmes pjesëmarrjes së barabartë të burrave dhe grave;
- Të përfronte politikat vendore me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare për barazi gjinore.

Përfundime dhe Rekomandime

Komisioni Barazisë Gjinore dhe Gjithpërfshirjes Sociale, pasi shqyrtoi dokumentacionin dhe bazën ligjore, bazuar edhe në degjues publikë të realizuar për këtë qëllim, arrin në përfundimin

se Plani i Barazisë Gjinore është një domosdoshmëri për zhvillimin e qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës të Bashkisë Tropojë. Ky plan kontribuon në forcimin e rolit të gruas, rritjen e mundësive të barabarta dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për të gjithë qytetarët.

Në këtë kuadër, Komisioni Barazisë Gjinore dhe Gjithpërfshirjes Sociale i propozon Këshillit Bashkiak Tropojë miratimin në tërësi të Planit të Barazisë Gjinore.